



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.44/2016

Prishtinë, më 7 dhjetor 2016

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi dhe Kujtim Paqaku.

Mungoi: Nenad Rashiq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinatori i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës, Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Eugen Cakolli-KDI, Behxhet Shala-KMDLNJ, Blerta Bejtullahu-EUSR/EU, Teuta Hoxha-YIHR KS, Sanije Berisha-OSBE, Florina Duli-Institucioni për Stabilitet, Sami Kurteshi-LVV, Naim Jaka- asistent GP-VV, Fehmi Pireva-Kuvendi, Ukë Gashi-ZPRK, Sanije Jusufi-Koha Ditore, Kujtesa Bajrami-RTV-21, Ismail Shabani-Kosova Press, Valmira Saraqi, KTV, Hajrudin Skenderi-Embsadae Zvicrës, Majlinda Doda-Radio Kosova, Besnik Tahiri-Klan Kosova dhe Edonë Popovci-BIRN.

Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit, i hapi punimet e mbledhjes, me pikën e vetme të

Rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Peticionit të 23.774 qytetarëve për zbardhjen e rastit të Astrit Deharit

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit, sot kemi në agjendë, shqyrtimin e Peticionit të 23 774 qytetarëve për zbardhjen e rastit të Astrit Deharit, peticion ky i dorëzuar në Kuvend, më 29. 11. 2016.

Lidhur me këtë çështje kryetarja theksoi se është e drejtë kushtetuese e qytetarëve për të shprehur vullnetin e tyre, dhe në këtë rast 23.774 qytetarë përmes nënshkrimeve të tyre kanë

adresuar në institucionet e Republikës së Kosovës, petitionin për zbardhjen e rastit të Astrit Deharit.

Më tej, ajo kërkoi mendimin e anëtarëve të Komisionit për datën e mbajtjes së Seancës Plenare lidhur me këtë petition, gjithnjë duke pasur parasysh domosdonë e harmonizimit të datës, për shkak të vizitës studimore në Suedi, nga anëtarët e Komisionit, e cila do të realizohet në mes të muajit dhjetor.

Kryetarja, në vazhdim, hapi diskutimet lidhur me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Mytaher Haskuka, shfaqti pakënaqësinë e tij rreth shtyrjes së mbajtjes së këtij takimi, por edhe të kërkesës së 40 deputetëve të cilët më herët kanë kërkuar mbajtjen e një Seance lidhur me këtë çështje. Lidhur me datën e mbajtjes së Seancës ai kërkoi që Kryesia të vendosë që të mbahet mbledhja e Kuvendit gjatë kësaj jave. Ai tha se duke pasur parasysh kërkesat që janë cekur në petition, do të ishte e mundur që ditën e nesërme, eventualisht pasnesër, të mbahet Seanca Plenare në të cilën do të diskutohet për rastin në fjalë.

Teuta Haxhiu, ritheksoi se edhe më herët ata kanë pasur një numër të konsideruar të nënshkrimeve që kanë kërkuar debat për rastin në fjalë. Ajo theksoi se në shqyrtim e kanë petitionin të cilin e kanë nënshkruar më shumë se 23000 qytetarë të Kosovës, të cilët kanë kërkuar shqyrtimin e këtij peticioni para datës 2 dhjetor 2016.

Ajo ishte e mendimit që më së largu ditën e pasnesërme të mbahet Seancë Plenare që do të diskutohet peticioni në fjalë dhe kërkesat e cekura në të.

Kryetarja, në lidhje me caktimin e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, sqaroi se sipas nenit 69, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, seanca e jashtëzakonshme mbahet me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të një të tretës së deputetëve.

Më pas, ajo i informoi anëtarët e Komisionit se Kryesia e Kuvendit ka vendosur që të mbahet Seancë e jashtëzakonshme, ndërsa për mënyrën e procedimit të asaj seance vendos Kryesia e Kuvendit.

Mytaher Haskuka tha se duhet pasur kujdes për datën e mbajtjes së Seancës sepse do të mbahet gjykimet ndaj disa deputetëve, si dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut do të jetë në vizitë studimore jashtë vendit. Ai kërkoi nga anëtarët e Komisionit që bëjnë pjesë në shumicën parlamentare që të nënshkruajnë kërkesën për Seancën e jashtëzakonshme, sepse momentalisht janë 39 nënshkrime dhe nevojitet vetëm edhe një nënshkrim që të plotësohet kriteri kushtetues për nënshkrimin e 1/3 të deputetëve.

Salihe Mustafa tha se sipas bindjeve të saja, vullneti i deputetëve të Komisionit është që të diskutohet lidhur me këtë çështje dhe të bëhet hetim i pavarur. Ajo theksoi se janë duke e diskutuar kushtet ligjore në bazë të cilave subjektet e caktuara mund të thërrasin Seancë të Jashtëzakonshme. Lidhur me këtë ajo tha se Kryesia e Kuvendit ka vendosur për këtë, mirëpo dilemat kanë mbetur rreth datës së mbajtjes së Seancës më 13 apo më 14 dhjetor. Ajo ishte e mendimit që të presin deri sa të plotësohen kushtet për mbajtjen e Seancës sepse në datat e përmendura Komisioni do të jenë jashtë vendit për vizitë studimore.

Shukrije Bytyqi, lidhur me kërkesën për mbajtjen e Seancës së Jashtëzakonshme, tha se fillimisht kanë qenë nënshkrimet për një kërkesë të tillë, mirëpo pas presioneve të bëra dikush nga deputetët ka tërhequr nënshkrimin. Ajo kërkoi nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje që të punojë në këtë drejtim. Po ashtu kërkoi që mos të përdoren standarde të

dyfishta duke lënë mundësinë që disa çështje të diskutohen e disa mos të diskutohen. Ajo theksoi se deklaratat e përfaqësuesve të institucioneve kanë qenë shqetësuese për opinionin rreth kësaj ngjarje dhe kërkoi që sa më shpejt të plotësohen kushtet dhe të mbahet kjo Seancë.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se si Komision e shqyrtojnë ligjshmërinë e nënshkrimeve se a janë të vlefshme apo nuk janë. Po ashtu ajo e përmendi disa nënshkrues që janë nënshkruar në listat e theksuara se i përkasin komunave që nuk bëjnë pjesë në Republikën e Kosovës. Ajo theksoi se si Komision janë për ta përcjellë këtë peticion në Seancë, mirëpo duhet pasur kujdes me nënshkrimet e qytetarëve sepse ka të atillë që nuk e kanë shtetësinë e Kosovës. Në fund ajo kërkoi që pasi Komisioni të kthehet nga vizita studimore, ta bëjë një gjë të tillë dhe ta procedojnë këtë kërkesë në Kryesi në mënyrë që të diskutohet për këtë çështje.

Mytaher Haskuka, duke u ndërlidhur me parafolësen, theksoi se mund të ketë nënshkrues të atillë, mirëpo përcaktimet kushtetuese kërkojnë 10 000 nënshkrime, për të pasur të drejtë të iniciohen ndryshimet ligjore dhe duke u nisur nga kjo ky peticion çfarëdo kontrolli të vlefshmërisë t'i bëhet e kalon shifrën e 10 000 nënshkruesve. Sa i përket debatit ai tha se është vonuar mjaft me debatin dhe çdo vonesë po ndikon në humbjen e besimit të qytetarëve në institucionet e Republikës së Kosovës. Ai ishte i mendimit se është më e dobishme që të mbahet debati sa më shpejt dhe të përfundohet kjo çështje. Ai në fund e përsëriti kërkesën e tij që ndonjëri nga anëtarët e Komisionit të nënshkruaj listën ku janë nënshkruar 39 deputetë dhe Seanca të mbahet më 9 dhjetor 2016.

Etem Arifi mbështeti qëndrimin që kjo çështje duhet të diskutohet në Kuvendin e Kosovës. Ai në vazhdim theksoi se nuk janë këtu për të diskutuar për nënshkrim apo jo, mirëpo si Komision janë duke e shqyrtuar një peticion i cili i ka plotësuar kushtet që të shqyrtohet në Komision që si fushëveprim të tij ka edhe fushën e peticioneve. Dilemat janë se sa ata mund të ndikojnë në ndryshimin e agjendës së Kryesisë së Kuvendit, rreth datës së mbajtjes së Seancës. Ai kërkoi që Komisioni t'i rekomandojë Kryesisë së Kuvendit që ta thërret një Seancë në bazë të agjendës së paraparë nga Kryesia.

Kryetarja sqaroi se rreth rastit Dehari kanë pritur që të informohen më saktësisht nga Institucioni i Avokatit të Popullit, e më pas të veprojnë si Komision.

Pas përfundimit të diskutimeve lidhur me këtë çështje, kryetarja propozoi që Peticioni i 23.774 qytetarëve për zbardhjen e rastit të Astrit Deharit, të shqyrtohet në seancë plenare, ndërsa data e mbajtjes së kësaj seance të caktohet nga Kryesia e Kuvendit, në bashkëpunim me Komisionin Funkcional.

Kryetarja hodhi në votim propozimin e lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte: 5 (pesë) vota për, 1 (një) abstenim dhe 2 (dy) kundër.

Më pas, kryetarja konstatoi se:

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 07.12.2016, e shqyrtoi Peticionin e 23.774 qytetarëve për zbardhjen e rastit të Astrit Deharit dhe vendosi që Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë këto:

REKOMANDIME

1. Të radhitet për shqyrtim në Seancë plenare Peticioni i 23.774 qytetarëve për zbardhjen

e rastit të Astrit Deharit.

2. Data e shqyrtimit në seancë plenare të caktohet në bashkëpunim me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

A R S Y E T I M

Komisioni Funkcional, pas shqyrtimit të Peticionit të 23.774 qytetarëve për zbardhjen e rastit të Astrit Deharit, vendosi që t'i propozojë Kryesisë së Kuvendit që ta radhiti për shqyrtim në seancë plenare.

Komisioni Funkcional, gjithashtu i propozon Kryesisë së Kuvendit që data e shqyrtimit të kësaj çështje në seancë plenare të caktohet në bashkëpunim me këtë Komision, nga se anëtarët e komisionit, nga data 12-16 dhjetor 2016, do të qëndrojnë zyrtarisht në një vizitë studimore në Suedi.

Arsyetimin e rekomandimit në Kuvend do ta paraqesë Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Lirije KAJTAZI